

VENDIM
Nr. 203, datë 25.3.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 186, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E NJËSIVE ZBATUESE PËR RINDËRTIMIN E BANESAVE INDIVIDUALE DHE NDËRTIMIN E RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “iii”, dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 186, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për rindërtimin, sipas projekteve model, të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale jashtë zonave të reja, të shpallura në bashkitë Durrës, Kavajë, Rrogozhinë e Shijak.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe